



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivered	23 - 11	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	7078 / 2023		114	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1239/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1239/2023 të datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesi

Komuna Shtimes, kundër organit të punësimit Komuna e Shtimes, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 22.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1239/2023 e datës 02.10.2023 e parashtruar nga ankuesi

Arsyetim

Ankuesi i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për Shërbime Publike" në Drejtorinë për Shërbime Publike, në Komunën e Shtimes në bazë të Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 05.09.2018, me datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6358/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e mbushjeve telefonike për tri vite 2019, 2020, 2021, uniformën për tri vite, përfshirë tri palë tesha, tri këmisha dhe tri palë këpucë si dhe shtesat e ndara nga Qeveria për kohë të pandemisë për dy muaj nga 200 euro.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.10.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtimes, ndërsa Këshilli më datë 24.10.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Shtimes, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6358/2023 të datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykim nga Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.1258/20 i datës 26.11.2021; Njoftim lidhur me shuarjen e masës disiplinore me numër 02/1-04 i datës 26.01.2022; Përgjigje në kërkesë nga Menaxheri i Personelit në Komunën e Shtimes me numër 02/1-293 i datës 07.09.2023; Vendim i Kryetarit të Komunës së Shtimes me numër 02Nr.13 i datës 26.01.2022; E-mail nga Rr.S. për [ankesa.kpmschck@rkës-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rkës-gov.net) i datës 02.10.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.10.2023; Përgjigje në ankesë e datës 24.10.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 23.10.2023; Vendim i Kryetarit të Komunës së Shtimes me numër 02Nr.78 i datës 05.09.2018; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 29.05.2015; Ndryshim dhe plotësimi i Aktit të Emërimit i Rr.S. i datës 05.09.2018; Kërkesë për kompensimin e mbushjeve telefonike dhe uniformës si për shtesat të ndara nga Qeveria për kohë të pandemisë e ankuesit i datës 14.04.2023; Kontratë për furnizim nga zyra e prokurimit Komuna e Shtimes me numër Nr.03/1/015 i datës 01.07.2020; Kontratë nga Drejtoria e Prokurimit me numër Nr.03/1/015 i datës 20.04.2021;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar i Shërbimeve Publike" në Drejtorinë për Shërbime Publike, në Komunën e Shtimes në bazë të Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 05.09.2018, kurse nxjerrjes së plotësim ndryshimit të aktit të emërimit i ka paraprirë Vendimit me numër 02Nr.78 i datës 05.09.2018 të Kryetarit të Komunës së Shtimes, përmes të cilit ankuesi nga pozita e punës "Inspektor i Shërbimeve Publike dhe Komunikacionit" në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, është sistemuar në vendin e punës "Zyrtar i Shërbimeve Publike" në Drejtorinë për Shërbime Publike.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Kryetari i Komunës së Shtimes me datë 26.01.2022 ka nxjerr Vendim me numër 02Nr.13 përmes të cilit e shfuqizuar Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit 02/Nr.470 të datës 08.09.2018, ashtu që ankuesi është kthyer në pozitën e punës "Inspektor i Shërbimeve Publike dhe Komunikacionit" sipas Akt Emërimit Nr.02/1/12 i datës 31.01.2011.

Tutje, me datë 14.04.2023 ka bërë kërkesë për kompensimin e mbushjeve telefonike dhe uniformës si për shtesat të ndara nga Qeveria për kohë të pandemisë tek zyra e personelit në

Komunën e Shtimes. Ndërsa Menaxheri i Personelit në Komunën e Shtimes ankuesit i ka kthyer përgjigje me arsyetimin se kërkesa e juaj e parashtruar pranë zyrës tonë me nr.02-07/9650/23 me datë 14.04.2023, nuk mund të shqyrtohet nga ne për shkak se nuk jemi kompetent për trajtimin e një kërkesë të tillë.

Ankuesi i pakënaqur me datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e mbushjeve telefonike për tri vite 2019, 2020, 2021, uniformën për tri vite, përfshirë tri palë tesha, tri këmisha dhe tri palë këpucë si dhe shtesat e ndara nga Qeveria për kohë të pandemisë për dy muaj nga 200 euro me arsyetimin se i njëjti ishte degraudar përmes Vendimit të datës 05.09.2018 të Kryetarit të Komunës së Shtimes, përmes të cilit ankuesi nga pozita e punës "*Inspektor i Shërbimeve Publike dhe Komunikacionit*" në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, është sistemuar në vendin e punës "*Zyrtar i Shërbimeve Publike*" me supozimin se një çështje të tillë e ka konfirmuar edhe Gjykatat Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr.1258/2020 të datës 26.01.2021.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin e tillë, thekson faktin se Aktgjykimi A.nr.1258/2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 26.01.2021, në vetë nuk përmban vendosje meritore, respektivisht përmes aktgjykimit në fjalë gjykatat kompetente e ka shfuqizuar Njoftimin e datës 21.08.2019 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e detyruar Këshillin të vendosë meritorisht lidhur me ankesën e ankuesit të datës 15.01.2019. Këshill me qëllim të zbatimit të Vendimit të Aktgjykimit A.nr.1258/2020 të datës 26.01.2021, me datë 31.12.2021 ka nxjerrë Vendimin A.nr.1058/2021 përmes të cilit e ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit të datës 15.01.2019 duke e ndryshuar Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 28.8.2018 ashtu që masën e shqiptuar disiplinore në kohëzgjatje prej pesë (5) vitesh e ka ndryshuar me periudhë efektive prej një (1) viti, kurse Komuna e Shtimes me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit ka nxjerr vendimin me datë 26.01.2022 ka nxjerr Vendim me numër 02Nr.13 duke e kthyer ankuesin në pozitën e tij sipas akt emërimit të datës 31.01.2011.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se për periudhën të cilën ankuesi kërkon që t'i bëhet kompensimi i mbushjeve telefonike për tri vite 2019, 2020, 2021, uniformën për tri vite, përfshirë tri palë tesha, tri këmisha dhe tri palë këpucë si dhe shtesat e ndara nga Qeveria për kohë të pandemisë për dy muaj nga 200 euro i njëjti nuk ka qenë duke e ushtruar pozitën e punës "*Inspektor i Shërbimeve Publike dhe Komunikacionit*", ngase ankuesi sipas Vendimit me numër 02Nr.78 të Kryetarit të Komunës së Shtimes, nga data 05.09.2018 ka ushtruar detyrën e punës në pozitën "*Zyrtar i Shërbimeve Publike*" deri me datë 26.01.2022, rrjedhimisht gjatë kësaj periudhe kohore për të cilën ankuesi kërkon shtesat në fjalë nuk e a ushtruar pozitën e "*Inspektor i Shërbimeve Publike dhe Komunikacionit*".

Bazuar në konstatimet si më lartë, si dhe duke ju referuar dispozitave ligjore në fuqi, përcaktohet që zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, siç parashihet me nenin 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (që ka qenë në fuqi), ndërsa Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili ka qenë në fuqi gjatë periudhës kur ankuesi pretendon se i takon kompensimi përkatësisht neni 9 paragrafi 1, ka përcaktuar se: "*Nëpunësit*

civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës”, si rrjedhojë meqenëse ankuesi nuk ka pasur asnjë akt juridik që ka ushtruar detyrat e punës për pozitën “Inspektor i Shërbimeve Publike dhe Komunikacionit” në Drejtorinë për Shërbime Publike në Komunën e Shtimes për periudhën për të cilën kërkon që ti bëhet kompensimi i mbushjeve telefonike për tri vite 2019, 2020, 2021, uniformën për tri vite, përfshirë tri palë tesha, tri këmisha dhe tri palë këpucë si dhe shtesat e ndara nga Qeveria për kohë të pandemisë për dy muaj nga 200 euro, pasi që i njëjti sipas vendimit me numër 02Nr.78 të datës 05.09.2018 të Kryetarit të Komunës së Shtimes ka qenë i risistemuar nga vendi i punës “Inspektor i Shërbimeve Publike dhe Komunikacionit” në Drejtorinë për Shërbime Publike, sistemohet në vendin e punës “Zyrtar i Shërbimeve Publike” në Drejtorinë për Shërbime Publike, atëherë nuk mund të bëhet asnjë lloj kompensimi për këtë çështje, rrjedhimisht edhe pretendimi i tij për kompensim është i pabazuar.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1239/2023

Çlirim Zeka

  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtimes;
- Arkivit të KPMSHCK-së.